



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

### NJOFTIM PËR SHTYP

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij më datë 26.04.2023, mori në shqyrtim tre njoftime përqendrimi të realizuara në tregun ndërkombëtar.

1. Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.
2. Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.
3. Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA-AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Përqendrimet e njoftuara nuk krijojnë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, nuk do të sjellin asnjë ndryshim dhe nuk do të kenë ndikim në tregun shqiptar

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 977, datë 26.04.2023, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK; me Vendimin nr. 978, datë 26.04.2023, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK; dhe Vendimin nr. 979, datë 26.04.2023, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA-AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Për më tepër, ju lutem konsultoni faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në <http://caa.gov.al>.